

RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT - SHQIPËRIA 2016

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Republika e Shqipërisë është demokraci parlamentare. Kushtetuta ia njeh autoritetin ligjor pralamentit me një dhomë (Kuvendit), i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërsa presidenti zotëron pushtet të kufizuar ekzekutiv. Në qershor 2015 vendi zhvilloi zgjedhje lokale për kryetarë bashkie dhe këshilla bashkiakë. Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE) e vlerësoi ditën e zgjedhjeve përgjithësisht pozitivisht por vuri re disa parregullsi procedurale. Në vitin 2013, vendi zhvilloi zgjedhje parlamentare të cilat sipas raportimit të OSBE-së ishin konkurruese dhe respektuan liritë themelore, por u zhvilluan në atmosferë mosbesimi e cila ndikoi gjithë mjedisin zgjedhor.

Autoritetet civile mbajtën nën kontroll efektshëm forcat e sigurisë.

Problemet më serioze në lidhje me të drejtat e njeriut ishin korrupsioni i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes, në veçanti brenda sistemit gjyqësor dhe sistemit të shëndetësisë, dhuna në familje dhe diskriminimi i grave.

Probleme të tjera me të drejtat e njeriut përfshinë kushte nën standardin e pranuar në burgje dhe dhomat e paraburgimit, sidomos mbipopullim, infrastruktura të vjetra, dhe mungesë trajtimi mjekësor për të burgosurit. Thuhet policia dhe rojet e burgjeve në disa raste kanë rrahur dhe keqtrajtuar të dyshuarit dhe të burgosurit dhe me raste, kanë mbajtur personat përtej afateve të paraburgimit pa asnjë akuzë. Presioni politik, kërcënimi, korrupsioni i përhapur dhe burimet e kufizuara ndonjëherë e penguan sistemin e drejtësisë nga funksionimi i tij në mënyrë të pavarur dhe eficiente. Qeveria shënoi pak përparim në trajtimin e shumë pretendimeve për rikthimin e pronës së marrë gjatë kohës së komunizmit. Autoritetet prishën shtëpi dhe sipërmarrje pa kaluar nëpërmjet procesit ligjor të duhur apo pa iu dhënë pronarëve të drejtën për të marrë shpërblimin e përshtatshëm. Qeveria, bizneset dhe grupet kriminale u përpoqën të ndikojnë median në mënyra të gabuara, dhe pati raportime të dhunës dhe kërcënimeve ndaj njerëzve të medias. Gazetarët shpesh përdorën vetë-censurën për të shmangur dhunën dhe ngacmimet, dhe si përgjigje e presioneve nga pronarët dhe kryeredaktorët. Vazhdoi të kishte tregues të abuzimit të gjerë me fëmijët. Martesat me detyrim dhe të hershme ishin problem në disa pjesë të vendit. Kishte shumë

fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë rruge, veçanërisht brenda komunitetit rom. Vendi vazhdoi të ishte burim dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë të shfrytëzuar për trafikim për arsye seksuale dhe punë të detyruar. Marxhinalizimi dhe abuzimi me komunitetet rome dhe egjiptiano-ballkanike ishin probleme serioze, siç ishte edhe diskriminimi bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Zbatimi i ligjeve të punës nga ana e qeverisë mbeti i dobët dhe rrallë mbrojti punëtorët e brendshëm dhe migrantë. Pati një numër të madh fëmijësh të përfshirë në punë të detyruar. Pati raporte diskriminimi nga ana e punëdhënësve bazuar në gjini, aftësi të kufizuara, orientim seksual dhe identitet gjinor, kombësi dhe origjinë etnike.

Pandëshkueshmëria mbeti problem. Ndjekja penale, dhe veçanërisht prova e fajësisë, e zyrtarëve që kishin kryer abuzime mbetën sporadike dhe të paqëndrueshme. Zyrtarë, politikanë, gjyqtarë dhe ata me interesa të forta biznesi shpesh arritën të shmangnin ndjekjen penale. Autoritetet ndërmorën disa masa teknike, siç ishte pagesa elektronike e gjobave për trafikun, për të përmirësuar përgjegjshmërinë e policisë, si dhe dënuan disa zyrtarë të niveleve të ulëta për abuzime.

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit, përfshirë lirinë nga:

a. Privimi i jetës në mënyrë arbitrare ose Vrasje të Tjera të paligjshme apo të Motivuar Politikisht

Nuk pati raportime që qeveria ose agjentë të saj të kenë kryer vrasje në mënyrë arbitrare ose të paligjshme.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime zhdukjesh për motive politike.

c. Tortura dhe trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose denigruese

Ndonëse kushtetuta dhe ligji i ndalon sjellje të tilla, policia dhe gardianët e burgut ndonjëherë dhunojnë dhe abuzojnë me të dyshuarit dhe të paraburgosurit. Deri në shtator, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm dhe Ankesave mori ankesa për abuzim dhe korrupsion në radhët e policisë, gjë e cila çoi në masa administrative dhe ndjekje penale.

Më 3 mars, Komiteti për Parandalimin e Torturës së Këshillit Europian (CTP) bëri publik raportin mbi vizitën e tij më të fundit në vend, më 2014. Ashtu si edhe më

2010, CTP-ja raportoi për marrjen e një numri të madh raportimesh të besueshme nga të paraburgosurit, përfshirë edhe minorenë, të cilat flasin për keqtrajtime fizike nga forcat policore, kryesisht shpulla, grushta, shkelma, dhe goditje me shkop.

Deri në shtator, Avokati i Popullit mori 140 ankesa nga të paraburgosurit. Pothuajse një e katërta e ankesave pretendonin se kishin abuzuar me ta fizikisht ose psikologjikisht; zyra e Avokatit të Popullit ia dërgoi tre prej tyre prokurorëve.

Kushtet në burgje dhe në qendrat e paraburgimit

Mungesa e trajtimit mjekësor, sidomos për çështjet e shëndetit mendor, ishte një problem serioz, ashtu sikurse edhe ndërtesat e mbipopulluara dhe infrastruktura e dobët fizike e tyre. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) raportoi se kushtet në disa qendra paraburgimi ishin aq të papranueshme sa përbënin trajtim çnjerëzor. Autoritetet përmirësuan disa ndërtesa të paraburgimit të policisë si pjesë e një plani përmirësimi në mbarë vendin, por kushtet mbetën të këqija jashtë Tiranës dhe qendrave të tjera të mëdha urbane. Kërkimet e KSHH-së të kryera me të burgosurit deri në korrik treguan se pjesa më e madhe e ankesave kishin të bënin me kushte jo të mira jetese, ndërhyrje në letërkëmbimet me anëtarë të familjes, mosreagim ndaj ankesave dhe kërkesave të të burgosurve, si dhe abuzime fizike dhe psikologjike nga personeli i burgut ose të burgosur të tjerë. Deri në korrik, gjashtë raste, ose afërsisht 11 përqind e të gjitha ankesave, pretendonin për abuzim fizik ose psikologjik.

Kushtet fizike: Popullsia e burgjeve ka qenë mesatarisht 9 përqind më e madhe se kapaciteti i përcaktuar i mjediseve të burgut. Mbipopullimi ishte veçanërisht serioz në qendrat e paraburgimit për ata që janë në pritje për gjykim. Kushtet në burgje dhe qendra paraburgimi për gra ishin përgjithësisht më të mira sesa ato për burra.

Qeveria raportoi për 12 vdekje në burgje deri në gusht; 10 ishin nga shkaqe natyrore, një nga një aksident zjarri në burgun e Lezhës dhe një nga vetvrasja. Më 30 korrik, një qeli në Lezhë u përpi nga flakët, duke rezultuar në vdekjen e një të burgosuri, dhe plagosjen e pesë të tjerëve dhe dy rojeve. Si pasojë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve pushoi nga puna 11 punonjës dhe mori masa disiplinore ndaj 21 të tjerëve. Më 31 korrik, një i burgosur në burgun e Vaqarrit u qëllua me armë zjarri dhe u plagos në oborrin e burgut. I burgosuri mori ndihmë mjekësore; hetimi vazhdoi deri në fund të vitit.

Pjesa më e madhe e 140 ankesave të marra nga Avokati i Popullit prej të burgosurve deri në shtator kishte të bënte më së shumti me cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Të burgosurit u ankuan gjithashtu edhe për qasjen ndaj programeve të lejes së veçantë, vonesa në zbatimin e urdhrave të transferimit të të burgosurve,

si dhe transferime të padëshiruara në burgje të tjera. KSHH raportoi gjithashtu edhe për një numër në rritje të ankesave për cilësinë e shërbimeve shëndetësore, si dhe transferimet/mos-transferimet midis ndërtesave të paraburgimit. Avokati i Popullit dhe organizatat joqeveritare (OJQ-të) raportuan se autoritetet mbajtën të burgosur me aftëzi të kufizuara mendore në burgje normale, ku qasja ndaj kujdesit shëndetësor mendor ishte tërësisht i papërshtatshëm.

Kushtet e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit ndryshonin sipas vjetërsisë dhe llojit të ndërtesave. KSHH pikasi probleme në strukturat e reja dhe të reja, siç janë lagështira në qeli, higjenë e dobët, mungesë të materialeve për shtretër, si dhe mungesë të furnizimit me ujë.

Kushtet në mjediset e varura nga Ministria e Punëve të Brendshme, si për shembull rajone policie dhe mjedise të përkohshme ndalimi, ishin tërësisht të papërshtatshme, përjashtuar mjediset rajonale në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë dhe Korçë, të cilat qeveria i rindërtoi në vitin 2014. Në shumë raste, mjediset e paraburgimit ishin pa ngrohje gjatë dimrit. Disa kishin mungesë të komoditeteve bazë të higjenës, si për shembull dushe ose lavamane. Ndërtesat ishin shumë të vogla, kishin akses të kufizuar në banja, dhe pak ose aspak ajrosje, dritë natyrale, krevate ose stola.

Administrimi: Ministria e Drejtësisë menaxhon burgjet e vendit. Avokati i Popullit raportoi se drejtuesit e burgjeve dhe policisë në përgjithësi bashkëpunojnë me hetimet. OJQ-të dhe Avokati i Popullit vunë re se mbajtja e të dhënave ishte e papërshtatshme në disa institucione, sidomos në rajonet e vogla ose rurale të policisë.

Korrupsioni vazhdoi të ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit, sidomos në lidhje me aksesin në punë dhe programet e posaçme të lirimit. OJQ-të raportuan se ata që ishin pjesë e programeve të punës morën më pak se 125 lekë (1 dollar) në muaj dhe nuk iu njohën sigurimet shoqërore.

Monitorimi i pavarur: Qeveria lejoi grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, median, si edhe organe ndërkombëtare si Komiteti për Parandalimin e Torturës i KiE-së, të monitoronin kushtet e burgjeve. Avokati i Popullit kreu kontrole të shpeshta të palajmëruara në qendrat e paraburgimit. Në shtator, Avokati i Popullit tha se i ishte ndaluar hyrja në burgun e Fierit për të hetuar pretendimet për dhunë ndaj një të burgosuri.

Përmirësimet: Gjatë vitit Avokati i Popullit dhe OJQ-të raportuan se kushtet në pjesën më të madhe të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit u përmirësuan.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve deklaroi se në korrik, mbipopullimi i burgjeve ishte ulur nga 25 përqind përtej kapacitetit të plotë në 2015, në 9 përqind. OJQ-të raportuan se autoritetet e policisë dhe të burgjeve treguan ndjeshmëri më të madhe ndaj të drejtave të të paraburgosurve të rinj dhe atyre femra. Avokati i Popullit raportoi se autoritetet ishin më tolerante në lejin e të rinjve në qendrat e paraburgimit të takoheshin me të afërmit e tyre. Mjedisi i burgut Jordan Misja në Tiranë, i cili u mbyll në 2015 pasi Avokati i Popullit e kishte cilësuar të papërshtatshëm, u rihap me kushte të përmirësuara jetese.

d. Arrestimi dhe ndalimi në mënyrë arbitrare

Ligji dhe kushtetuta ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare, dhe qeveria në përgjithësi i zbatoi këto ndalime.

Roli i Policisë dhe i Aparatit të Sigurisë

Ministria e Punëve të Brendshme mbikëqyr Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Policinë e Kufirit dhe Migracionit. Policia e Shtetit është organizmi kryesor përgjegjës për sigurinë e brendshme. Garda e Republikës mbron zyrtarët e lartë të shtetit, personalitetet e huaja dhe disa prona shtetërore. Ministria e Mbrojtjes mbikëqyr forcat e armatosura, të cilat ndihmojnë gjithashtu në kohë nevojash humanitare. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) mbledh informacion, kryen veprimtari zbulimi dhe kundërzbulimi të huaj, dhe varet nga kryeministri.

Autoritetet civile në përgjithësi ruajtën kontroll të efektshëm mbi policinë, Gardën e Republikës, forcat e armatosura dhe Shërbimin Informativ Shtetëror, megjithëse disa zyrtarë përdorën herë pas here burimet shtetërore për përfitime personale dhe disa pjesëtarë të forcave të sigurisë kryen abuzime.

Policia nuk e zbatoi gjithmonë në mënyrë të barabartë ligjin. Njohjet personale, lidhjet politike ose kriminale, infrastruktura e dobët, mungesa e pajisjeve ose mbikëqyrja e dobët shpesh ndikuan zbatimin e ligjeve. Pagat e ulëta, motivimi i ulët dhe drejtimi i dobët dhe mungesa e diversitetit në vendin e punës çuan në korrupsion dhe sjellje joprofesionale të vazhduar. Autoritetet u përpoqën t'i adresojnë këto probleme duke rinovuar ndërtesat e policisë, duke përmirësuar mjetet e tyre, duke prezantuar kamerat e instaluar në makina dhe në trup, si dhe duke nënvizuar publikisht masat kundër korrupsionit.

Pandëshkueshmëria mbeti problem serioz, megjithëse qeveria bëri përpjekje më të mëdha për ta korrigjuar, në veçanti duke rritur përdorimin e provave të filmuara për të dokumentuar dhe proceduar penalisht sjelljen e gabuar të policisë. Në prill, Gjykata e Lartë mbështeti vendimet për një dhe tre vjet të dhëna respektivisht

gardistëve Ndreja Prendi dhe Agim Llupo, të akuzuar për vrasjen e katër protestuesve në vitin 2011.

Ndonëse qeveria ka mekanizma për të hetuar dhe ndëshkuar korrupsionin dhe abuzimin, korrupsioni në rradhët e policisë mbeti problem. Shërbimi i qeverisë për çështjet e brendshme dhe ankesat kreu kontrole, iu përgjigj ankesave dhe ndërmori hetime serioze mbi të drejtat e njeriut, kushtet e burgjeve, dhe zbatimin e procedurave standarte të veprimit. Kjo zyrë iu përgjigj 2202 ankesave, përfshirë 1777 telefonata në linjën falas kundër korrupsionit. Deri në shtator, autoritetet trajtuan me 34 çështje të 46 oficerëve të përfshirë në shkelje administrative dhe tetë çështje të tetë oficerëve të përfshirë në shkelje kriminale, dhe ia dërguan ato për ndjekje penale. Gjatë vitit Avokati i Popullit gjithashtu hetoi ankesa kundër zyrtarëve të policisë, kryesisht të lidhura me probleme të arrestimit dhe paraburgimit.

Qysh prej vitit 2014, qeveria ka rritur pagat e policisë dhe ka shpallur konkurs për punësimet e reja, megjithëse Akademia e Policisë raportohet të ketë ushtruar ndikim të papërshtatshëm mbi punësimet, pushimet nga puna dhe rritjet në detyrë. Policia nuk zbatoi plotësisht urdhrin e veçantë i cili kërkon që gratë të përbëjnë 50 përqind të punësimeve të reja, me qëllimin e arritjes së 30 përqind të përfaqësimit të grave në tërësinë e forcës së policisë. Emërimi i një specialisti të diversitetit në mars e rriti vëmendjen e zyrtarëve ndaj këtij problemi.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të paraburgosurve

Sipas ligjit, me përjashtimin e atyre që arrestohen në flagrancë, policia mund të arrestojë një të dyshuar vetëm me mandat të lëshuar nga një gjykatë dhe të bazuar në prova të mjaftueshme. Nuk ka patur raportime në lidhje me arrestime sekrete. Me ligj, policia duhet të informojë menjëherë prokurorinë për ndalimin. Prokuroria mund ta lirojë të dyshuarin ose t'i bëjë kërkesë gjykatës brenda 48 orësh për ta mbajtur atë më gjatë. Gjykata duhet të vendosë brenda 48 orësh nëse do ta vendosë të dyshuarin në paraburgim, do të kërkojë garanci, do t'i ndalojë lëvizjet, ose do t'i kërkojë të pandehurit detyrim paraqitjeje në polici. Prokuroria kërkoi dhe gjykatat urdhëruan paraburgim në shumë raste penale, megjithëse gjykatat ndonjëherë hodhën poshtë kërkesat e prokurorisë për ndalim të të pandehurve me lidhje të forta dhe pozitë të lartë.

Kushtetuta u kërkon autoriteteve të njohin personat e ndaluar menjëherë me akuzën e ngritur kundër tyre dhe me të drejtat që ata zotërojnë. Autoritetet e zbatimit të ligjit nuk e respektuan gjithmonë këtë detyrim. Mungonte sistemi efikas për menaxhimin e aspektit monetar të garancisë. Në vend të saj, gjykatat shpesh urdhëruan të dyshuarit të paraqiteshin në polici ose prokurori një herë në javë.

Ndondëse ligji u jep të ndaluarve të drejtën e marrjes së menjëhershme të një avokati, me shpenzimet e shtetit nëse është e domosdoshme, OJQ-të raportuan se ata shpesh janë marrë në pyetje pa praninë e një avokati. Autoritetet lanë shumë të dyshuar në arrest shtëpie, shpesh me kërkesën e tyre, sepse nëse do të dënoheshin më pas u llogaritej koha nën arrest si kohë dënimi.

Sipas ligjit, policia duhet të transferojë të paraburgosurit nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka mjedise më të përshtatshme për ndalim afatgjatë, nëse ndalimi kalon afatin prej 10 orësh. Për shkak të mbipopullimit në sistemin e dënimit, të paraburgosurit, përfshirë të rinjtë, mbetën në dhomat e ndalimit të policisë për periudha të gjata.

Arrestimi në mënyrë arbitrare: Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin në mënyrë arbitrare. Megjithëse qeveria në përgjithësi i mori parasysht këto ndalime, pati raste të herëpashershme kur policia ndaloi persona për t'i marrë në pyetje për një kohë më të gjatë pa i arrestuar formalisht.

Ndalimi në pritje të gjykimit: Ndonëse ligji kërkon përfundim të të gjitha hetimeve përpara gjykimit brenda tre muajsh, prokuroria mund ta zgjasë këtë periudhë deri në dy vjet ose më gjatë. Ligji kërkon që ndalimi në pritje të gjykimit të mos kalojë tre vjet; nuk pati raportime që autoritetet t'i kenë shkelur këto afate gjatë vitit. Ndalimi i gjatë përpara gjykimit shpesh ndodhi për shkak të vonesës së hetimeve, gabimeve të mbrojtjes ose mosparaqitjes me qëllim të avokatëve mbrojtës. Me ligj, gjyqtari nuk mund t'i parandalojë këto veprime ngadalësuese duke akuzuar avokatin që nuk paraqitet për fyerje të trupit gjykues. Burimet e kufizuara materiale, menaxhimi i dobët i kalendarit të gjykatës, stafi i pamjaftueshëm dhe mosparaqitja e avokatëve dhe dëshmitarëve kanë penguar sistemin gjyqësor të gjykojë çështjet sipas afateve kohore. Deri në shtator, pothuajse gjysma e popullsisë së burgjeve dhe qendrave të paraburgimit ishin në pritje të gjykimit.

Mundësia e të Paraburgosurit për të kundërshtuar Përpara Gjyqit Mbajtjen e Paligjshme: Kodi i Procedurën Penale kërkon që gjykata të shqyrtojë nevojshmërinë e paraburgimit brenda tre ditëve. Nëse masa e paraburgimit nuk është hequr, personi në paraburgim mund të apelojë në Gjykatën e Lartë. Nëse nuk është marrë asnjë vendim brenda kohës së dhënë, paraburgimi bëhet i pavlefshëm. Kodi i Procedurës Penale kërkon gjithashtu që prokurori të japë përditësime dy mujore mbi informacionin e marrë pas paraburgimit. Kjo përfshin përmbledhje të dëshmive dhe fakteve të dokumentuara që janë marrë. Nëse ka garanci, gjykatësi mund të anulojë paraburgimin bazuar në informacionin e ri.

Ndalim i zgjatur i azilkërkuesve të refuzuar ose personave pa shtetësi: Autoritetet shpesh ndaluan persona të parregullt që hynë pa dokumenta në vend. Deri në

shtator, policia kishte ndaluar në kufirin jugor me Greqinë 500 emigrantë; emigrantët që u ndaluan edhe më gjatë, kryesisht kaluan deri në një muaj në qendrën e paraburgimit në Karrec. Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët e OKBs-së mundi të monitoronte procesin, ndalimin dhe deportimin e emigrantëve. Qeveria raportoi se më pak se 10 përqind e emigrantëve kërkuar strehim, edhe pse OJQ-të pretendonin se disa emigrantë që kërkuan strehim mund të jenë deportuar. UNCHR-ja raportoi se kushtet në qendrën e Karrecit ishin të papërshtatshme, veçanërisht për fëmijët. Në gusht, qeveria nisi lëvizjen e disa emigrantëve në qendrën e hapur për emigrantët në Babrru, ku kushtet ishin më të mira.

e. Mohimi i gjyqit të drejtë publik

Megjithëse kushtetuta garanton gjyqësor të pavarur, trysnia politike, kërcënimi, korrupsioni i përhapur dhe burimet e kufizuara hera-herës ndaluan gjyqësorin të vepronte i pavarur dhe në mënyrë efikase. Seancat dëgjimore në gjykata shpesh nuk ishin të hapura për publikun. Punonjësit e sigurisë së gjykatave shpesh refuzuan të lejonin vëzhguesit në seanca dëgjimore dhe rregullisht telefononin gjyqtarin kryesues për ta pyetur nëse mund të lejonin ose jo ndonjë individ që kërkonte të ndiqte seanca të caktuara. Disa agjenci shfaqën një model shpërfilljeje ndaj urdhrave të gjykatës. Politizimi i emërimeve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese kërcënuan të cenonin pavarësinë dhe integritetin e këtyre institucioneve. Deri në shtator dy vende të lira në Gjykatën e Lartë mbetën pa zëvendësuar pas thujse tre vjetësh, pavarësisht rasteve të prapambetura me të cilat përballej gjykata.

Në përgjithësi, Ministria e Drejtësisë nuk vijoi me rigorozitet masat disiplinore kundër gjyqtarëve. Kur e bëri këtë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ngurronte t'i vinte në zbatim ato masa. Deri në tetor ministria kishte nisur procedime disiplinore kundër tetë gjyqtarëve. Nga këta, autoritetet pushuan një gjykatës, pezulluan një tjetër, dhe transferuan njërin prej tyre në një juridiksion tjetër. Me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme, Gjykata e Lartë urdhëroi pezullimin e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Ky gjyqtar u akuzua më pas për marrje ryshfeti, dhe çështja ishte pezull deri në fund të vitit.

Procedurat e gjykimit

Ligji i prezumon të pandehurit të pafajshëm derisa t'u jepet dënimi. Ai parashikon që të pandehurit të njoftohen menjëherë dhe me hollësi për akuzat kundër tyre, me përkthim falas nëse është e nevojshme, si dhe të kenë gjykim publik të lirë e të

drejtë pa vonesa të tepruara. Të pandehurit kanë të drejtën të jenë të pranishëm në gjyqin e tyre, të konsultohen me avokat dhe t'u sigurohet një i tillë me pagesën e shtetit nëse nuk e përballojnë dot. Ligji u siguron të pandehurve kohë dhe mjedise të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, akses për përkthim falas dhe të drejtën për të marrë prova të mbledhura nga organi i akuzës. Të pandehurit kanë të drejtë të përballen me dëshmitarët kundër tyre dhe të paraqesin dëshmitarë e prova në mbrojtjen e tyre. Të pandehurit nuk mund të detyrohen të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë. Të pandehurit kanë të drejtën të apelojnë. Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta, megjithëse gjyqet nuk ishin gjithmonë publike dhe mundësia për të marrë avokat disa herë ishte problematike. Pavarësisht të drejtës statutore për ndihmë ligjore falas, OJQ-të raportuan se shumë pak individë përfituan nga kjo gjatë vitit.

Të dënuarit dhe të ndaluarit politikë

Nuk pati raportime për të dënuar ose të ndaluar politikë.

Procedurat gjyqësore dhe kompensimet civile

Ndonëse individët dhe organizatat mund të kërkojnë kompensime civile për dhunim të të drejtave të njeriut, gjykatat ishin pre e korrupsionit, mungesës së efikasitetit, kërcënimeve, dhe ndërhyrjeve politike. Gjykatësit organizuan shumë seanca dëgjimore në zyrat e tyre, gjë që tregoi mungesë profesionalizmi dhe ofroi mundësi për korrupsion. Këta faktorë cenuan autoritetin e gjyqësorit, kontribuan në vendime gjyqi kontradiktore dhe çuan në zbatim të paqëndrueshëm të kodit civil.

Personat që përdorën të gjitha mundësitë në gjykatat vendore mund të apelonin në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Që nga shtatori, 495 raste ishin në pritje para GJEDNJ-së, shumica në lidhje me moszbatimin e vendimeve të brendshme gjyqësore ose administrative. Në shumë raste, autoritetet nuk i vunë në zbatim vendimet e GJEDNJ-së. Një studim i vitit 2013 nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur për Shqipërinë—Fondacioni Soros zbuloi se avokatët, prokurorët dhe gjykatësit kishin njohuri të kufizuara në lidhje me jurisprudencën e GJEDNJ.

Personat që ishin të burgosur politikë nën regjimin e mëparshëm komunist vazhduan t'i bënin kërkesë qeverisë për kompensim. Në disa raste, pati protesta nga grupe të burgosurish politikë, kundër mosshlyerjes së pagesave të kompensimit nga qeveria, të përfituara me ligj. Ligji i jep përparësi kompensimit të grave, të moshuarve, atyre me sëmundje serioze, dhe atyre që nuk kanë marrë asnjë pagesë. Qeveria përparoi me pagesat e kompensimeve gjatë vitit.

Rikthimi i pronës

Mijëra pretendime për pronë private dhe fetare konfiskuar gjatë periudhës së komunizmit mbetën të pa zgjidhura nga Agjencia e Trajtimit dhe Kompensimit të Pronave. Pretenduesit mund t'i apelojnë çështjet në Gjykatën Evropiane (GJEDNJ) dhe gjatë vitit qindra raste—shumë prej tyre lidhur me pronën—ishin në pritje të shqyrtimit atje.

f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Inspektorati Kombëtar i qeverisë për Mbrojtjen e Territorit (NIPT) shkatërroi disa shtëpi të ndërtuara pa leje si pjesë e fushatës më të gjerë të shkatërrimit të ndërtimeve të paligjshme. Deri në gusht, Avokati i Popullit mori 16 ankesa të qytetarëve ndaj NIPT, duke përfshirë dështimin për të siguruar paralajmërim të mjaftueshëm me shkrim, dështim për të shqyrtuar kërkesën e një pronari shtëpie për legalizimin e pronës, dhe pakujdesi e cila rezultoi në dëmtim të pronave të tjera personale, të tilla si mobilje dhe struktura të tjera.

Gjatë gjithë vitit banorët e rajonit të Himarës u ankuan për ashpërsi të etikuar nga qeveria drejt tyre e cila rezultoi në shkatërrimin e pjesshëm ose të plotë të shumë shtëpive dhe të biznesit me shumë pak paralajmërim dhe pa mbështetje ligjore për kompensim adekuat. Autoritetet thanë se prishjet ishin të nevojshme për zhvillim komercial dhe ruajtjen kulturore. Banorët pohuan se qeveria shpesh nuk e njohu dokumentacionin ligjor të pronësisë dhe i shpronësoi pronaret e shtëpive dhe të tokave me kompensim minimal financiar.

Seksioni 2. Respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë:

a. Liria e fjalës dhe e shtypit

Kushtetuta garanton lirinë e fjalës dhe të shtypit, dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta. Pati raportime se qeveria, biznesi dhe grupet kriminale kërkuan të ndikonin median në mënyrë të papërshtatshme.

Liritë e shtypit dhe të medias: Media e pavarur ishte aktive dhe shprehu një gamë të gjerë pikëpamjesh, megjithëse pati disa përpjekje për të ushtruar tryzni të drejtpërdrejtë ose jo, politike e ekonomike në media, përfshirë kërcënime dhe dhunë kundër gazetarëve që u përpoqën të hetonin histori krimi dhe korrupsioni. Trysnia politike, korrupsioni dhe mungesa e fondeve e kanë kufizuar median e shkruar të pavarur, dhe gazetarët raportuan se kishin praktikuar vetë-censurim.

Mediat në internet (online) patën një rritje dramatike gjatë vitit, e cila shtoi diversitetin e pikëpamjeve. Sipas vlerësimeve të 2015, rreth 15 për qind e 1500 gazetarëve të vendit kanë punuar në mediat online.

Në raportin vjetor Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias, Bordi Ndërkombëtar i Kërkimit dhe Shkëmbimit tregoi se kriza ekonomike ka vazhduar të dëmtojë pavarësinë e medias. Të paktën një gazetë e madhe u mbyll për arsye financiare. Financimi për organizatat që guxonin për një shtyp më të pavarur mbeti i kufizuar, dhe shtypi ishte i ndjeshëm ndaj keqpërdorimit nën presion të vazhdueshëm politik dhe ekonomik.

Shumica e qytetarëve i marrin lajmet e tyre nga televizioni dhe radio. Pavarësia e Autoritetit të Mediave Audiovizive, rregullatorit të tregut të mediave transmetuese, ka mbetur e diskutueshme. Roli i autoritetit mbeti i kufizuar, edhe pasi bordi i tij u plotësua në mes të vitit.

Në maj, Gjykata Kushtetuese vendosi në favor të një peticioni nga Shoqata e Medias Elektronike shqiptare për të shfuqizuar një ligj që pengonte një individ aksioner të zotëronte më shumë se 40 për qind të aksioneve në një media elektronike kombëtare. Disa vëzhgues e vlerësuan këtë vendim si hapje rruge për monopolizimin e mundshëm të numrit vërtet të vogël të licensave kombëtare të transmetimit dixhital. BE-ja, Këshilli i Europës dhe OSBE-ja kishin kritikuar më parë një përpjekje të 2015 nga Kuvendi për të anuluar të njëjtin nen.

Ndonëse stacionet private televizive në përgjithësi kanë vepruar të lirë nga ndikimi i drejtpërdrejtë i qeverisë, shumë pronarë përdorën përmbajtjen e transmetimeve të tyre për të ndikuar veprimet e qeverisë drejt bizneseve të tyre. Pronarët e bizneseve gjithashtu përdorën lirshëm kompani mediatike për të përfituar favore dhe për të promovuar interesat e tyre me partitë politike.

Dhuna dhe ngacmimi: Pati raportime dhune dhe kërcënimi kundër anëtarëve të medias si dhe interesat politike dhe ato të bizneseve kanë çuar gazetarët nën trysni. Intimidimi i gazetarëve nëpërmjet mediave sociale ka vazhduar.

Më 9 maj, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë denoncoi rrahjen e rëndë të gazetarit sportiv Eduard Ilnica, sipas pretendimeve, për raportimin e sjelljeve të dhunshme të një trajneri gjatë një ndeshje futbolli. Autoritetet arrestuan trajnerin dhe e liruan me kusht. Ka pasur raporte se Ilnica ka vendosur të mos ngrinte padi pas arritjes së një marrëveshje private me të pandehurin, por prokuroria e çoi çështjen në gjykatë; pritej gjykimi i çështjes.

Censura dhe kufizimet e përmbajtjes: Gazetarët shpesh praktikuan vetë-censurimin për të shmangur dhunën e ngacmimit, dhe si reagim ndaj trysnisë prej botuesve dhe redaktorëve që kërkonin të avanconin interesat e tyre politike dhe ekonomike. Një studim i 2015-ës nga Rrjetit Rajonal Investigativ i Ballkanit në Shqipëri zbuloi se kompanitë e mëdha tregtare dhe reklamuesit e rëndësishëm ishin burimet kryesore të presionit.

Mungesa e sigurisë ekonomike uli pavarësinë e reporterëve dhe ndikoi në njëanshmëri në raportime. Sindikatat e gazetarëve shqiptarë vazhduan të raportonin vonesa të konsiderueshme në pagesat e pagave për gazetarët në shumicën e mediave. Problemet financiare detyruan disa gazetarë të mbështeteshin më shumë në burime të jashtme financimi.

Më 20 gusht, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë dënoi të ashtuquajturin shkarkim arbitrar të Alida Tota, drejtoreshë lajmesh në A1TV, sipas pretendimeve për raportimin e vdekjes në gusht të një djali 17-vjeçar që punonte në landfillin e Sharrës në afërsi të Tiranës. Një letër nga pronari i këtij stacioni për Totën, e cila u publikua në media deklaronte se ajo ishte punësuar për një periudhe prove të pacaktuar dhe do të pushohej nga detyra e saj. Tota pohoi se ajo u shkarkua për shkak se historia e Sharrës bënte përgjegjëse Bashkinë e Tiranës për kushtet e punës së fëmijëve në këtë landfill.

Ligjet për shpifjen: Ligji lejon palët private të dorëzojnë padi penale dhe të marrin kompensim financiar për fyerje ose botim të qëllimshëm të informacionit të pavërtetë. OJQ-të raportuan se gjobat, të cilat mund të ishin deri në 3 milion lekë, ishin të tepërta dhe e kombinuar me vendosjen e një dënimi në rekordet penale të të pandehurit, ato rrezikuan lirinë e shprehjes.

Liria e internetit

Qeveria nuk kufizoi ose ndërpreu aksesin në internet e as nuk censuroi përmbajtjen online, dhe nuk pati raportime të besueshme që qeveria të ketë monitoruar komunikimet private online pa autoritetin e duhur ligjor. Sipas të dhënave të muajit qershor nga e Statistikat Botërore të internetit, 1.82 milionë persona, ose rreth 60 për qind e popullsisë, e përdorën internetin. Rreth 35 për qind e përdoruesve hynë në internet nëpërmjet telefonave celularë.

Liria akademike dhe avktivitetet kulturore

Nuk pati kufizime nga qeveria të lirisë akademike dhe aktiviteteve kulturore.

b. Liria për grumbullim paqësor dhe formimi i shoqatave

Kushtetuta dhe ligji garantojnë liritë e grumbullimit dhe shoqatave, dhe qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

c. Liria e fesë

Shikoni *Raportin Ndërkombëtar për Lirinë e Fesë* nga Departamenti i Shtetit në faqen www.state.gov/religiousfreedomreport/.

d. Liria e lëvizjes, personat e zhvendosur brenda vendit, mbrojtja e refugjatëve dhe personat pa shtetësi

Kushtetuta dhe ligji garantojnë lirinë e lëvizjes së brendshme, udhëtimeve jashtë shtetit, emigracionin dhe riatdhesimin, dhe në përgjithësi qeveria i respektoi këto të drejta.

Qeveria bashkëpunoi me UNHCR-në dhe organizata të tjera humanitare në dhënien e mbrojtjes dhe ndihmës për refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, personat pa shtetësi dhe persona të tjerë të lidhur me këto kategori. Policia e lejoi UNHCR-në të monitoronte procedimin, ndalimin dhe deportimin e disa personave.

Lëvizjet brenda vendit: Në mënyrë që të përfitojnë nga shërbimet qeveritare, individët që lëvizin brenda vendit duhet të transferojnë të dhënat e tyre civile në komunitetin e ri ku do të vendosen dhe të provojnë ligjshmërinë e banesës së tyre nëpërmjet pronësisë së banesës, një kontrate qiraje për përdorim banese ose faturave të shërbimeve. Shumë persona nuk mund të siguronin prova të tilla dhe si rrjedhojë nuk patën mundësi të përdorin shërbimet publike. Shtetas të tjerë, veçanërisht të komunitetit rom dhe egjiptiano-ballkanikë, nuk kishin regjistrime formale në komunitetet ku ishin vendosur të jetonin. Ligji nuk e ndalon regjistrimin e tyre, por ishte e vështirë të realizohej ky regjistrim. Shumë romë dhe egjiptiano-ballkanas nuk kishin mundësitë financiare për t'u regjistruar dhe shumë nuk kishin motivimin e duhur për t'u marrë me këtë proces.

Mbrojtja e refugjatëve

Mundësia për azil: Ligji siguron garantimin e azilit ose statusit refugjat dhe qeveria ka krijuar një sistem për dhënien e ndihmës ndaj refugjatëve.

Kishte raportime të besueshme nga OJQ-të dhe migrantët dhe azilkërkuesit se autoritetet nuk ndoqën detyrimet e procedurës së duhur ligjore për disa azilkërkues dhe se në raste të tjera ata që kërkonin azil nuk kishin akses në sistem. Deri në tetor disa 740 emigrantë dhe azilkërkues - kryesisht afganë dhe sirianë - hynë në vend. Autoritetet i kthyen shumicën e tyre në Greqi, disa menjëherë, të tjerë pas javësh të paraburgimit në ambiente të papërshtatshme. UNHCR kritikoi procedurat e ndalimit dhe shqyrtimit të emigrantëve nga qeveria, veçanërisht duke patur parasysh rritjen e pranisë së fëmijëve mes emigrantëve. Deri në tetor autoritetet u përgjigjën duke transferuar 18 emigrantë nga objekti i mbyllur i burgimit të emigrantëve në Karrec në qendrën e azilit të hapur në Babrru, ku kushtet e jetesës ishin shumë më tepër të përshtatshme për familje. Autoritetet gjithashtu strehuan në hotele më shumë se dymbëdhjetë emigrantë në pritje të kthimit në Greqi në vend të qendrës në Karrec.

Ligji mbi azilin u kërkon autoriteteve të japin ose mohojnë azilin brenda 51 ditësh nga kërkesa e parë e aplikantit. Azilkërkuesit nuk mund të përballen me akuza penale për hyrje të paligjshme nëse ata kontaktojnë autoritetet brenda 10 ditësh nga mbërritja në vend. UNHCR raportoi se nuk kishte monitorim efikas të sistemit të azilit.

Vend i sigurt origjine/Tranzit: Ligji ndalon individë nga vende të sigurta origjine të aplikojnë për azil ose status refugjati. Sidoqoftë, UNHCR raportoi se asnjë kërkesë azili nuk ishte refuzuar bazur në listën e qeverisë me vendet të sigurta, e cila përfshin Greqinë.

Punësimi: Ligji u lejon qasjen në punë të refugjatëve. Lëshimi i kufizuar i kartave të identifikimit dhe lejeve të punës, sidoqoftë, nënkuptoi që në fakt pak refugjatë punonin.

Mundësi të Përfitimit të Shërbimeve Bazë: Ligji siguron për migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët shërbime publike, përfshirë arsim, kujdes shëndetësor, strehim, zbatim ligji, procedura gjyqësore dhe ndihmë ligjore. Migrantët dhe azilkërkuesit shpesh kërkuan ndërhyrjen e UNHCR-së ose OJQ-ve lokale për të siguruar këto shërbime.

Zgjidhje të përhershme: Në shtator qeveria përfundoi procesin e pranimit të refugjatëve muhaxhedinëve iranianë nga Iraku dhe vazhdoi të lehtësonte integrimin e tyre përgjatë vitit.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguroi gjithashtu mbrojtje ndihmëse e të përkohshme për individët që mund të mos kategorizohen si refugjatë. Prej tetorit qeveria i ofronte këtë shërbim tre personave dhe mbrojtje të përkohshme për 24.

Personat pa shtetësi

Numri i personave pa nënshtetësi në vend ishte i paqartë. Në fund të vitit 2014, UNHCR-ja raportoi 7 443 persona pa shtetësi në vend, pjesa më e madhe e personave pa shtetësi ishin fëmijë romë dhe egjiptianë. Sipas UNHCR-së, 3,234 raste të mungesës së nënshtetësisë janë zgjidhur prej vitit 2011, por se sa nga këta ishin pjesë e 7,443 rasteve të fillimit nuk dihet. Ndërkohë, ekzistonte rreziku i mosshetësisë për fëmijët e lindur jashtë të emigrantëve që kthehen në vend dhe vazhdonte për fëmijët romë dhe egjiptianë. Ligji lejon mundësinë e marrjes së nënshtetësisë.

Seksioni 3. Liria për të Marrë Pjesë Në Procesin Politik

Kushtetuta dhe ligji përcaktojnë mundësinë e individit për të zgjedhur qeverinë në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta me votë të fshehtë bazuar në të drejtën universale dhe të barabartë të votës.

Zgjedhjet dhe Pjesëmarrja Politike

Zgjedhjet e Fundit: Zgjedhjet kombëtare parlamentare më të afërta u zhvilluan në vitin 2013. Misioni i vëzhgimit të zgjedhjeve i OSBE-së raportoi se ato “ishin konkurruese me pjesëmarrje aktive të shtetasve përgjatë gjithë fushatës dhe me respekt të vërtetë për liritë themelore.” OSBE-ja vërejti: “Atmosfera e mosbesimit ndërmjet dy forcave kryesore politike ndikoi mjedisin zgjedhor dhe sfidoi adiministrimin e të gjithë procesit zgjedhor.”

Në shtator u mbajtën zgjedhje të posaçme për kryetarin e Bashkisë Dibër pas pushimit nga puna të kryetarit të mëparshëm për abuzim me detyrën. Vëzhduesit ndërkombëtarë vlerësuan ngjarjet e ditës së votimit si të qeta dhe të mirë-organizuara. Megjithatë, në javët para zgjedhjeve, procesi u shënuar nga akuza të blerjes së votës dhe kërcënim i votuesve nga të dyja partitë politike.

Në qershor 2015 vendi zhvilloi zgjedhjet lokale në mbarë vendin për kryetarë bashkie dhe këshilla bashkiakë. OSBE-ja e vlerësoi Ditën e Zgjedhjeve përgjithësisht pozitivisht, por vërejti se ndonëse kuadri ligjor “mund të kishte

siguruar bazën për zgjedhje demokratike”, partitë kryesore keqpërdorën pushtetin dhe përgjegjësitë e tyre të gjera brenda administrimit të zgjedhjeve dhe nuk patën vullnetin politik të zbatonin kuadrin ligjor me efektivitet. Në raportin përfundimtar misioni i vëzhguesve të OSBE-së raportoi akuza të përhapura për presion mbi votuesit, të cilat, bashkë me raste të vëzhguara në ditën e zgjedhjeve, ngritën shqetësime për mundësinë e votuesve për të votuar lirisht. Misioni i vëzhgimit raportoi gjithashtu se mjedisi i fushatës ishte paqësor, me përjashtim të disa incidenteve të shkëputura, dhe se liritë themelore të shprehjes dhe grumbullimit u respektuan.

Pjesëmarrja e grave dhe pakicave: pjesëmarrja e grave në qeveri u rrit në mënyrë të qëndrueshme deri sa arriti një rekord prej 23 përqind të deputetëve gr në parlament dhe 30 përqind të ministrave. Ligji drejtues i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 kërkonte që 30 përqind e kandidatëve të ishin gra dhe që ato të përbënin 30 përqind të posteve me emërim dhe me zgjedhje. Gratë përbënin 18 përqind të anëtarëve të zgjedhur në parlament në vitin 2013. Sipas raportit të OSBE-së për zgjedhjet, sidoqoftë, tre partitë kryesore nuk e përmbushën kuotën 30- përqindëshe të detyruar për gratë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i gjobiti këto parti por gjithsesi i pranoi listat e tyre. Zgjedhjet lokale të qershorit 2015 u organizuan pas ndryshimeve të kodit zgjedhor që u kërkonin partive të alternojnë kandidatët burra dhe gra në listat e tyre. Sipas raportit përfundimtar të OSBE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, gratë u zgjodhën në më shumë poste, pothuajse një e treta, në këshillat lokale.

Kërkesat për regjistrim civil, përfshirë tarifat dhe mungesën e dokumenteve të identifikimit vështirësuan mundësitë e anëtarëve të komunitetit rom të votonin në zgjedhjet lokale të qershorit 2015. Disa vëzhgues deklaruan se partitë politike ofruan të paguanin këtë tarifë në shkëmbim të votës. Deri në tetor nuk pati ministra apo deputetë romë.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsionin e zyrtarëve, por qeveria nuk e zbatoi ligjin me efektivitet dhe zyrtarët shpesh u përfshinë në praktika korrupsioni pa ndëshkueshmëri. Në dhjetor të vitit 2015 Kuvendi miratoi legjislacionin e dekriminalizimit që parandalon individët me dënime penale nga shërbimi si kryetarë bashkish, deputetë, apo në qeveri dhe poste të tjera shtetërore.

Gjatë viti autoritet ndërmorën hapa shtesë për të luftuar korrupsionin. Në korrik Kuvendi miratoi unanimisht amendamete kushtetuese për të aprovuar një reformë të gjerë të gjyqësorit që përfshinte krijimin e institucioneve të reja antikorrupsion. Këtu përfshihet ngritja e një zyre të pavarur prokurori dhe një nëjsie hetimore, përgjegjësia e vetme e të cilave do të jetë hetimi dhe ndjekja penale e korrupsionit në nivele të larta dhe e krimit të organizuar. Në gusht, Kuvendi miratoi një ligj për vetingun që synon pakësimin e korrupsionit mes prokurorëve dhe gjykatësve. Qeveria gjithashtu zgjeroi përdorimin e kamerave të trupit tek oficerët e policisë për të shkurajuar korrupsionin e rrugës.

Një numër agjencish qeveritare hetuan raste korrupsioni por burimet e kufizuara, rrjedhjet e hetimeve, presione të vërteta ose të perceptuara politike dhe një sistem i çrregullt riemërimesh penguan hetimet. Ministria e Drejtësisë raportoi se dënimet në gjykatat e rretheve u ulën me 37 përqind në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Nuk pati të dhëna përsa i përket dënimeve në gjykatat e apelit. Në raste selektive që përfshinin aktorë ndërkombëtarë, agjencitë e antikorrupsionit bashkëpunuan me shoqërinë civile.

Korrupsioni: Korrupsioni ishte i përhapur në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fillim të vitit, 75 raste korrupsioni ishin ende pa gjykim, me 29 raste shtesë të filluara në qershor. Deri në gusht gjykatat dënuan 76 të pandehur për korrupsion; 25 raste u pushuan. Mbetën 121 raste për korrupsion që prisnin gjykimin. Deri në korrik, faqja e internetit ngritur në 2015 për të lejuar qytetarët të denonconin korrupsionin nga zyrtarët publikë kishte marrë 14,752 ankesa, 94 prej të cilave koordinatori i referoi për ndjekje penale.

Ndërsa prokurorët shënuan përparim në ndjekjen e korrupsionit në raste me profil të ulët publik, përfshirë gjykatës dhe prokurorë, ndjekja penale për krime të nivelit të lartë mbeti e papërfillshme për shkak të frikës së hetuesve për hakmarrje, mungesën e përgjithshme e burimeve, dhe korrupsionit brenda vetë gjyqësorit. Në shtator një gjykatë dënoi Spiro Kserën, ministër i punës nga qeveria e mëparshme, me 20 muaj burg për abuzim me detyrën pasi kishte përvetësuar 30 milionë lekë (\$240,000) që duhej të shkonin për përfitimin e komunitetit rom. Në maj autoritetet shkarkuan kryetarin e bashkisë së Dibrës, Shukri Xhelili, pas publikimit të pamjeve filmike në të cilat ai dukej se kërkonte favore seksuale nga një femër në shkëmbim për një vend pune. Xhelili apeloi vendimin në Gjykatë Kushtetuese e cila e mbështeti shkarkimin e tij.

Deklarimet financiare: Ligji u kërkon punonjësve publikë të deklarojnë pronat e tyre në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit

të Interesit (ILDKPKI), i cili monitoroi dhe verifikoi deklaramë të tilla. Inspektorati i bëri këto deklaramë të disponueshme për publikun. Gjatë vitit numri i inspektorëve të ILDKPKI-së për të hetuar deklaramë të pasurive dhe konflikteve të interesit nga 12 në 28. Ligji autorizon ILDKPKI-në të gjobisë zyrtarët të cilët nuk i përmbahen kërkesave për deklarim ose i referon ata në prokurori.

Deri në shtator, ILDKPKI-ja kishte gjobitur 253 individë, përfshirë ministra, zv/ministra, anëtarë Kuvendi, dhe krerë institucionesh për mosdeklarimin e pasurive të tyre, për vonesa në deklarime ose për konflikte interesi. ILDKPKI-ja raportoi se deri në gusht ajo kishte referuar 63 raste të reja për procedim. Këto raste përfshinin 13 gjykatës, dy prokurorë, shtatë anëtarë parlamenti, dy ambasadorë dhe 39 zyrtarë të qeverisë lokale me akuza që përfshinin refuzimin për deklarim, fshehjen ose falsifikimin e deklarimeve të pasurisë, pastrim parash, falsifikim dokumentesh dhe korrupsion.

Aksesi publik në informacion: Ligji parashikon akses publik në informacionin qeveritar, por qeveria nuk e zbatoi ligjin me efikasitet. Procesi i bërjes publike të informacionit shpesh nuk ishte i qartë dhe zyrtarët ndonjëherë ngurruan të lëshonin informacionin e kërkuar. Sipas një numër organizatash joqeveritare, shumica e informacionit të kërkuar prej ministrive dhe bashkive nuk morën përgjigje. Ligji përcakton se e drejta për të marrë informacion mund të kufizohet kur informacioni kategorizohet si i klasifikuar ose kur nxjerrja e tij do të shkelte mbrojtjen e të dhënave personale.

Pjesa më e madhe e ministrive dhe agjencive të qeverisë postuan informacion publik drejtpërdrejt në faqen e tyre në rrjet. Bizneset dhe shtetasit u ankuan se procesi nuk kishte transparencë dhe se autoritetet nuk kishin botuar rregulla që duhet të ishin informacion publik bazë. Shtetasit shpesh u përballën me probleme serioze për marrjen e informacionit të tillë. Individët në përgjithësi mund të merrnin informacionin qeveritar falas, por kishte raste në të cilat kërkoheshin tarifa përpunimi për të mbuluar koston e shërbimit për institucionin që jepte informacionin. Mospajtueshmëria është e ndëshkueshme si shkelje administrative, jo si shkelje penale. Shtetasit mund të apelojnë mohimin e deklarimit tek autoriteti ku bënë kërkesën fillestare ose në një gjykatë civile.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të dyshimeve për shkelje të të drejtave të njeriut

Një numër grupesh vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut vepruan në përgjithësi pa kufizim nga ana e qeverisë, duke hetuar dhe botuar gjetjet e tyre mbi

rastet e të drejtave të njeriut. Zyrtarët qeveritarë përgjithësisht ishin bashkëpunues dhe reagues ndaj këndvështrimeve të tyre.

Organizma Qeveritare të të Drejtave Të Njeriut: Zyra e Avokatit të Popullit është institucioni kryesor për promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit autorizohet nga ligji të monitorojë dhe raportojë mbi burgjet dhe qendrat e paraburgimit. Zyra e tij mund të hapë hetim në disa raste kur viktimat nuk mundet të dalë vetë publikisht. Megjithatë Avokati i Popullit nuk kishte fuqinë të zbatonte vendimet, ai vepronte si monitorues për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zyra e Avokatit të Popullit kishte mungesa në fonde dhe në personel. Avokati i Popullit raportonte në parlament çdo vit. Megjithatë parlamenti shpërndau kopje të disa prej raporteve vjetore dhe të veçanta të avokatit të popullit ose i postoi ato në internet, rrallë i diskutoi këto raporte në seanca ose komisione plenare. Kuvendi u konsultua me institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me projektligje mbi të drejtat e njeriut, por shpesh e bënë këtë në çastin e fundit, me kërkesë të avokatit të popullit.

Kuvendi ka një komision parlamentar për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut.

Seksioni 6. Diskriminimi, Abuzimet Shoqërore dhe Trafikimi i Personave

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi, përfshirë përdhunimin bashkëshortor, është krim. Ndëshkimet për përdhunim dhe ngacmim varen nga mosha e viktimës. Për përdhunimin e një të rrituri dënimi me burg është nga tre deri në 10 vjet; për përdhunimin e një adoleshenti të moshës nga 14 deri në 18 vjeç, dënimi është nga pesë deri në 15 vjet; dhe për përdhunimin e një fëmije nën moshën 14 vjeç, dënimi është shtatë deri në 15 vjet. Ligji përfshin dispozita mbi sulmin seksual dhe ngacmimin seksual dhe qartëson kriminalizimin e përdhunimit bashkëshortor. Qeveria nuk e zbatoi me efikasitet ligjin. Viktimat rrallë raportuan abuzimin bashkëshortor dhe zyrtarët nuk e ndoqën penalisht përdhunimin bashkëshortor. Koncepti i përdhunimit bashkëshortor nuk ishte i kuptuar drejt, dhe autoritetet dhe publiku shpesh nuk e konsideruan atë si krim.

Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin bashkëshortor, mbeti problem serioz. Policia shpesh nuk kishte trajnimin ose kapacitetin për të shqyrtuar si duhet rastet e dhunës në familje.

Deri në muajin gusht një strehë shtetërore për viktimat e dhunës në familje në Tiranë ndihmoi 24 gra dhe 40 fëmijë por nuk mund të pranonte viktimat pa një urdhër gjykate. Qeveria operoi një strehë për mbrojtjen e të mbijetuarve të dhunës në familje ndërsa OJQ-të drejtuan katër të tilla. Përveç këtyre, tre streha të organizatave joqeveritare siguruan mbrojtje për viktimat trafikimit, si dhe të viktimave të abuzimit.

Ngacmimi Seksual: Ligji ndalon ngacmimin seksual, megjithëse zyrtarët rrallë e zbatuan atë. OJQ-të dhe komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi besonin se ngacmimi seksual nuk raportohet në të shumtën e rasteve. Komisioneri për mbrojtje ndaj diskriminimit në përgjithësi shqyrtoi raste të ngacmimit seksual. Komisioneri mund të vendosë gjoba deri në 80,000 lekë (\$640) kundër individëve ose deri në 600,000 lekë (\$4,800) kundër ndërmarrjeve.

Të drejtat Riprodhuese: Çiftet dhe individët kanë të drejtën të vendosin për numrin e fëmijëve, distancën kohore mes fëmijëve dhe kohën kur dëshirojnë të kenë fëmijë; të menaxhojnë shëndetin e tyre riprodhues; dhe të kenë informacionin dhe mjetet për ta realizuar këtë pa diskriminim, detyrim ose dhunë. Cilësia dhe mundësia e marrjes së shërbimit shëndetësor të siguruar nga qeveria, përfshirë kujdesin obstetrik dhe atë pas lindjes, nuk ishin të kënaqshme, veçanërisht në zonat e thella rurale.

Diskriminimi: Ligji garanton status të njëjtë ligjor dhe të drejta të barabarta si për gratë dhe për burrat. Gratë nuk u përjashtuan nga ndonjë profesion as me ligj e as në praktikë, por në shumë fusha ato nuk ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta. Ligji dikton pagesë të barabartë për punë të barabartë, megjithëse shumë punëdhënës privatë nuk e zbatuan plotësisht këtë dispozitë. Në shumë komunitete gratë përjetuan diskriminim social bazuar në normat tradicionale sociale që i përshkruajnë gratë si të nënshtruara ndaj burrave. Pati raportime për diskriminim në punësim.

Përzgjedhja e Fëmijës Bazuar mbi Parapëlqimin Gjinator: Sipas agjencisë statistikore të qeverisë, raporti djem-vajza në lindje në vitin 2014 ishte 109 me 100, gjë që tregon se mund të ketë përzgjedhje të seksit të fëmijët bazuar tek parapëlqimi gjinator. Qeveria nuk mbështeti përpjekjet për të shqyrtuar mungesën e ekuilibrit gjinator.

Fëmijët

Regjistrimi i Lindjes: Individu merr nënshtetësinë me lindjen brenda territorit të vendit ose duke patur njërin prej prindërve nënshtetas. Prindërit u nxitën të regjistronin lindjen e fëmijës në kohën e duhur, dhe ligji parashikon një shpërblim monetar për prindërit që regjistrojnë fëmijët e tyre brenda 60 ditësh nga lindja. Megjithatë, shpesh autoritetet nuk i shpërndanë shpërblimet. Nuk pati raportime për diskriminim në regjistrimin e lindjes, por kërkesat rënduese për provën e rezidencës dhe banesës për regjistrim e bënë të vështirë atë për shumë prindër romë dhe egjiptiano-ballkanas të cilët nuk kishin dokumentacion ligjor për vendbanimet që të regjistronin fëmijët e tyre apo të merrnin shërbime shtetërore që varen nga regjistrimi.

Sipas degës vendore të organizatës joqeveritare Shoqata për Mbështetjen Sociale të Rinjve (ARSIS), fëmijët e lindur nga migrantë të brendshëm ose nga ata që janë kthyer nga jashtë shtetit, veçanërisht nga Greqia, shpesh nuk kishin certifikatë lindjeje ose dokumentacion tjetër të ligjshëm lindjeje dhe si rrjedhojë nuk mund të ndiqnin shkollën ose të përfitonin shërbime të tjera. Ky problem mbetet veçanërisht i ndjeshëm për familjet romë, ku çiftet shpesh martoheshin të rinj dhe nuk regjistronin lindjet e fëmijëve të tyre.

Arsimi: Ndjekja e shkollës është e detyrueshme deri në klasën e nëntë ose deri në moshën 16 vjeç, cilado vjen e para, por shumë fëmijë, veçanërisht në zona rurale, lanë shkollën më parë për të punuar me familjet e tyre. Prindërit duhet të blejnë mjetet shkollore, librat, uniformat dhe ngrohësit për disa klase; këto ishin shumë të shtrenjta deri të pamundura për shumë familje, veçanërisht familjet romë dhe pakica të tjera. Shumë familje gjithashtu përmendën këto kosto për mosdërgimin e vajzave në shkollë. Megjithëse qeveria kishte një program rimbursimi për familjet me të ardhura të ulëta për koston e librave shkollore, shumë familje dhe organizata joqeveritare raportuan se nuk ishte e mundur të merreshin rimbursimet pas blerjes së librave. Organizatat vunë në dukje se herë pas here mësuesit diskriminonin fëmijët romë për shkak të perceptimit të higjenës së tyre si të keqe.

Abuzimi me fëmijët: Vëshguesit besonin se abuzimi me fëmijët ishte i përhapur, megjithëse viktimat rrallë e raportuan këtë. Në vitin 2013 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi se 58 përqind e fëmijëve ishin viktimë të abuzimit fizik, 11 përqind ishin viktimë të ngacmimit seksual dhe thuajse 5 përqind thanë se kishin qenë viktimë të abuzimit seksual. Pothuaj 70 përqind e fëmijëve raportuan abuzim psikologjik nga anëtarë të familjes, sipas qendrës.

Martesa e Hershme dhe me Detyrim: Megjithëse minimumi i ligjshëm për martesë është 18 vjeç, autoritetet nuk e zbatuan ligjin. Martesat nën moshë ndodhnin më së

shumti në zonat rurale ose në bashkësitë rome. Sipas një studimi të vitit 2015 mbi *Martestat në Moshë të Hershme në Shqipëri* nga Observatori i Fëmijëve, rreth 3 përqind e fëmijëve mes moshës 15 dhe 18 ishin të martuar. Studimi gjithashtu vuri në dukje se 9 përqind e fëmijëve romë të moshës 13 deri 18 vjeç ishin të martuar. ARSIS pretendoi se në disa bashkësi rome, vajza vetëm shtatë vjeç dhe djem vetëm nëntë vjeç ishin quajtur të martuar. Disa OJQ raportuan se martesat e hershme dhe me detyrim ndodhën në komunitete rurale si pjesë e skemave të trafikimit njerëzor, kur prindërit pranuan që vajzat e tyre nën moshë të martoheshin me burra të huaj më të mëdhenj në moshë, të cilët më pas i çonin ato në vende të tjera.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Dënimet për shfrytëzimin në tregëti seksi të fëmijëve varionin nga tetë deri në 15 vjet burg. Vendi ka një ligj që dënon përdhunimin, dhe mosha minimale për marrëdhënie seksuale me dëshirë është 14 vjeç. Dënimi i parashikuar me ligj për përdhunimin është burgim nga pesë deri në 15 vjet. Në rrethana të rënduara, dënimi mund të shkojë deri në burgim të përjetshëm. Ligji ndalon prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë me fëmijë; dënimet janë burgim nga tre deri në 10 vjet. Zotërimi i pornografisë së fëmijëve është i paligjshëm. Ligji qartazi përfshin minorenët në dispozita që mbulojnë abuzimin seksual, ngacmimin, shfrytëzimin për prostitucion, përfitimin nga shërbime të ofruara nga persona të trafikuar, lehtësimin e trafikimit dhe dhunën në familje.

Autoritetet në përgjithësi zbatuan me efikasitet ligjet kundër përdhunimit dhe shfrytëzimit seksual të minorenëve, por OJQ-të raportuan se ligjet që ndalonin pornografinë me fëmijë rrallë u vunë në zbatim. Disa fëmijë nën moshën 18 vjeç u shfrytëzuan për prostitucion.

Fëmijët e Zhvendosur: Vazhdoi të kishte shumë fëmijë të zhvendosur dhe fëmijë në rrugë, veçanërisht nga bashkësitë rome. Fëmijët e rrugës lypnin ose bënin punë të vogla; disa migruan në vendet fqinje, veçanërisht gjatë verës. Këta fëmijë ishin më të rrezikuarit nga trafikimi dhe disa prej tyre ranë viktima të trafikimit. Duke qenë se ligji ndalon procedimin penal të fëmijëve nën moshën 14 vjeç për vjedhje shtëpish, bandat kriminale herë pas here përdornin fëmijët e zhvendosur për të plaçkitur shtëpi. Pati pak ndjekje penale për raste të trafikimit të fëmijëve.

Një studim i vitit 2014 nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët UNICEF dhe Save the Children zbuloi se më shumë se 2,500 fëmijë, afërsisht 75 përqind e tyre nga komunitete rome dhe egjiptiano-ballkanike, lypnin ose punonin në mënyrë informale në rrugë. Shumica e fëmijëve pretendonin se fitimi i parave për familjet

e tyre ishte arsyeja kryesore pse ata lypnin ose punonin, dhe gati një e treta e tyre thanë se prindërit i detyronin të punonin. Sipas raportit, një e treta e fëmijëve që punonin ose rrinin në rrugë rrezikonin të trafikoheshin.

Si pasojë, qeveria zbatoi një program pilot në Tiranë për të hequr fëmijët nga rruga duke u dhënë atyre kujdes social. Një tjetër program pilot u dha stimuj financiar prindërve që t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkolla dhe t'i vaksinonin. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve raportoi se autoritetet kishin hequr 345 nga 808 fëmijët rrugë të identifikuar midis korrikut 2015 dhe qershorit 2016. ARSIS raportoi se fëmijët vazhduan të punon në fushat me kanabis në mbarë vendin.

Fëmijët në Institucione Përkujdesjeje: Media raportoi se pati raste të abuzimit të fëmijëve në jetimoret e Shkodrës, Durrësit dhe Sarandës. Në prill avokati i popullit hetoi jetimoren e Shkodrës dhe rekomandoi procedim penal ndaj disa anëtarëve të personelit për abuzimin fizik dhe psikologjik, si dhe shfrytëzimin e fëmijëve për punë. Hetimi ishte ende duke u kryer në fund të vitit.

Mbajta e fëmijëve migrantë në njësinë e pritjes në Karrec u konsiderua e papërshtatshme për fëmijë, megjithëse një numër i vogël fëmijësh migrant qëndruan aty për periudha që varionin nga disa ditë në disa jave.

Rrëmbime Ndërkombëtare të Fëmijëve: Vendi është palë e Konventës së Hagës për Aspektet Civile të Rrëmbimeve Ndërkombëtare të Fëmijëve, e vitit 1980. Shih *Raportin Vjetor për Rrëmbimin Ndërkombëtar Prindëror të Fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në adresën travel.state.gov/content/childabduction/en/legal/compliance.html.

Anti-Semitizmi

Sipas raportimeve, vetëm disa qindar hebrenj jetonin në vend. Nuk pati raportime për akte anti-semitike.

Trafikimi i Personave

Shih *Raportin për Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në adresën www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

Personat me Paaftësi

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë diskriminimin kundër personave me paaftësi fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore në punësim, arsim, transport, akses në kujdesin shëndetësor, sistemin gjyqësor dhe ofrimin e të tjera shërbimeve shtetërore. Megjithatë, punëdhënësit, shkollat, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe ofrues të shërbimeve të tjera shtetërore ndonjëherë kryenin diskriminim. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, 24 përqind e personave me paaftësi nuk kishin ndjekur kurrë shkollën. Varfëria e përhapur, kushtet e parregulluara të punës, si dhe kujdesi jo i mirë shëndetësor paraqisnin problem domethënëse për shumë persona me paaftësi.

Në qershor, qeveria miratoi Planin Kombëtar të Veprimit 2016-20 për Personat me Paaftësi, mbështetur nga një buxhet shtetëror prej 1.5 miliardë lekë (\$12 million). Qeveria po ashtu financoi Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Paaftësisë me pesë milionë lekë (\$40,000) për prodhimin e karrigeve me rrota. Qeveria sponsorizoi agjenci të shërbimeve sociale për të mbrojtur të drejtat e personave me paaftësi, por këto agjenci zakonisht kishin mungesa financimi për të vënë në zbatim programet e tyre. Kufizimet në burime dhe mungesa e infrastrukturës e bënë të vështirë që personat me paaftësi të merrnin pjesë plotësisht në çështje civile. Qendrat e votimit shpesh ndodheshin në mjedise që iu mungonin lehtësitë për të tillë persona.

Avokati i Popullit inspektonte institucionet e shëndetit mendor në mënyrë të rregullt. Si pranimi ashtu edhe nxjerrja e pacientëve në institucione të shëndetit mendor ishin problematike për shkak të burimeve të mjaftueshme financiare për të ofruar vlerësimet e duhura psikiatrike. Ekzistonte diskriminim dhe stigmatizim shoqëror ndaj personave me paaftësi mendore apo të llojeve të tjera.

Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Ekzistonin pretendime për diskriminim domethënës ndaj personave të komuniteteve romë dhe egjiptiano-ballkanike, përfshi në strehim, punësim, kujdes shëndetësor dhe arsim. Disa shkolla bënë rezistencë për pranimin e nxënësve romë dhe egjiptiano-ballkanikë, sidomos nëse dukeshin të varfër. Shumë shkolla të përziera që pranonin nxënës romë i marginalizonin ata në klasa, hera-herës duke i veçuar fizikisht nga nxënësit e tjerë.

OJQ të të drejtave të romëve kritikonin mungesën e mbrojtjeve ligjore kundër dëbimit dhe shkatërrimit të kampeve romë që përfshihen në ligjin për legalizimin e pronave. Dëbimet dhe shkatërrimet vazhduan gjatë vitit dhe prekën shumë familje romë. Qeveria administronte programe strehimi alternativ për familjet e dëbuara,

përfshi romët, por këto programe zakonisht nuk ishin të qëndrueshme pa mbështetje domethënëse nga OJQ-të dhe donatorët e jashtëm.

Ligji siguron status të pakicës zyrtare për grupet kombëtare dhe etnogjuhësore. Qeveria përcaktonte grekët, maqedonasit dhe malazezët si grupe kombëtare; grekët përbënin më të madhin ndër këto grupe. Ligji i përkufizonte arumunët (vllahët) dhe romët si grupe pakicash entogjuhësore.

Pakica kombëtare greke ankohej për mungesën e vullnetit të qeverisë për të njohur qytete etnike greke jashtë “zonave minoritare” të kohës së komunizmit apo të përdorte greqishten në dokumentet dhe tabelat publike në zonat etnike greke. Arsimi publik nuk ekzistonte në gjuhët rome, serbo-kroatishit apo vllahe.

Akte Dhune, Diskriminimi dhe Abuzime të Tjera Bazuar në Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor

Ligji ndalon diskriminimin bazuar në orientimin seksual, përfshi në punësim. Deri në gusht, komisioneri i qeverisë për mbrojtjen nga diskriminimi mori pesë ankesa nga individë e organizata lesbike, gay, biseksuale, transgjinorë dhe persona interseks (LGBTI). Zbatimi i ligjit përgjithësisht ishte i dobët. Në maj, Këshilli i Ministrave miratoi Planin Kombëtar të Veprimit për LGBTI 2016-2020, dhe në gusht, një urdhër i kryeministrit ngriti Grupin Kombëtar për Zbatimin dhe Bashkërendimin për të zbatuar planin e veprimit. Plani i veprimit synon të përmirësojë kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e personave LGBTI; të eliminojë të gjitha format e diskriminimit; dhe të përmirësojë aksesin në punësim, arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime strehimi.

Orientimi seksual dhe identiteti gjinor janë ndër grupet e mbrojtura nga ligji i vendit për krimin e urrejtjes. Pavarësisht ligjit dhe mbështetjes formale të qeverisë për të drejtat e LGBTI, qëndrimet homofobike mbetën në jetën private dhe publike. Hera-herës, zyrtarët publikë bënë deklaratat homofobike. OJQ-të raportuan se familjet debuan persona LGBTI nga shtëpitë gjatë vitit. Deri në gusht, streha për personat e dëbuar LGBTI, hapur në vitin 2014, strehonte 12 individë.

Në 14 maj, aktivistët morën pjesë në Paradën e katërt për të Drejtat e Komunitetit Homoseksual kundër Homofobisë, një paradë e shkurtër me biçikleta në bulevardin kryesor të Tiranës dhe shqiptarët panë spotin e parë televiziv mbi të drejtat e barabarta të familjes. Si pjesë e një “festivali diversiteti,” aktivistët organizuan edhe aktivitete të tjera, të tilla si njohja publike e 30 personave që mbështesnin kauzën LGBTI. Policia garantoj sigurinë e aktivistëve gjatë aktiviteteve. Në maj,

kompania për vendosjen e personave në vende pune Headhunters Albania nxori një indeks renditjeje lidhur me masën në të cilën kompanitë private respektonin ligjet e punësimit që mbrojnë orientimin seksual. Indeksi i 71 kompanive tregoi se 62 përqind kishin politika përfshirëse të burimeve njerëzore, por vetëm 3 përqind trajtuan specifikisht mosdiskriminimin e kandidatëve LGBTI për vendet e punës.

Stigma Shoqërore ndaj HIV dhe SIDA

Ligji ndalon diskriminimin kundër personave me HIV/SIDA. Megjithatë, në anketimin më të fundit demografik dhe të shëndetit (2008-09), 71 përqind e femrave dhe 69 përqind e meshkujve HIV-pozitivë raportuan qëndrime diskriminuese ndaj personave me HIV. Të tillë persona përjetuan stigmë të përgjithshme shoqërore, edhe pse nuk pati raportime për dhunë ndaj të tillë individëve gjatë vitit.

Dhunë a Diskriminim Tjetër nga Shoqëria

Gjatë vitit ndodhën incidente të vrasjeve shoqërore, përfshi vrasjet për “gjakmarrje” dhe ato për hakmarrje. Media i portretizoi disa vrasje të lidhura me bandat si vrasje për gjakmarrje dhe hera-herës, kriminelët e përdornin termin për të justifikuar krimet e tyre. Nuk pati raste të minoreneve apo femrave që ranë viktimat të vrasjeve për gjakmarrje. Avokati i Popullit raportoi se përpjekjet e autoriteteve për të mbrojtur familjet apo parandaluar vrasjet nga gjakmarrja ishin të pamjaftueshme, edhe pse qeveria i rriti përpjekjet për t’i ndjekur penalisht të tilla krime.

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e grupimit në shoqata dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji dhe rregullore e statute të tjera të lidhura me të sigurojnë të drejtën për pjesën më të madhe të punonjësve të formojnë sindikata, të bëjnë greva të ligjshme dhe të bëjnë marrëveshje kolektive. Ligji ndalon diskriminimin kundërsindikata dhe siguron rikthimin në punë të punonjësve të pushuar për shkak të veprimtarisë në sindikatë. Ligji nuk lejon anëtarë të ushtrisë dhe zyrtarë të lartë të qeverisë të bëhen pjesë e sindikatave dhe kërkon që një sindikatë të ketë së paku 20 anëtarë për t’u regjistruar. Ligji garanton të drejtën e grevës për të gjithë punëtorët me përjashtim personelin ushtarak në uniformë, personelin e policisë, personelin e domosdoshëm mjekësor e spitalor, personat që ofrojnë shërbim të kontrollit të trafikut ajror dhe shërbime në burgje, si edhe punonjësit e domosdoshëm ose jo të ujësjellësit dhe

kompanisë së energjisë elektrike. Punonjësit që nuk përjashtohen nga pozicionet e tyre e ushtruan të drejtën e tyre për grevë. Këto ligje rrallë mbrojtën punëtorët shtëpiakë dhe migrantët. Sindikatat e punonjësve ishin kryesisht të dobëta dhe të politizuara. Punonjësit që përfshihen në greva ilegale mund të detyrohen të paguajnë për çdo dëmtim që vjen si pasojë e veprimeve të grevës.

Zbatimi i këtyre ligjeve nga qeveria mbeti gjerësisht jo efektiv, pjesërisht nga përhapja e punësimit informal. Burimet për kryerjen e inspektimeve dhe kompensimin e shkeljeve nuk ishin të mjaftueshme. GJobat e lartë, të cilat sipas ligjit mund të arrijnë në 1.1 milionë lekë (8,700 dollarë) ose deri në pesëdhjetëfish të pagës minimale, rallë u vlerësuan. Masat administrative dhe procedurale iu nënshtruan vonesave të gjata dhe apelimeve. Procedurat e arbitrazhit lejuan vonesa të mëdha të cilat kufizuan mbrojtjen e punonjësve kundrejt veprimtarisë kundër sindikatës.

Punonjësit civilë në të gjitha fushat kanë të drejtën kushtetuese të organizohen dhe të bëjnë marrëveshje kolektive, dhe ligji përcakton procedura për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve për diskutim kolektiv. Sindikatat që përfaqësonin punonjësit e sektorit publik negociuan në mënyrë të drejtpërdrejtë me qeverinë. Në këtë mjedis, marrëveshjet kolektive edhe kur arriheshin ishin të vështira për t'u zbatuar. Drejtuesit e sindikatave shpesh u shkarkuan për shkak të lidhjeve politike.

b. Ndalimi i punës me detyrim

Ligji ndalon të gjitha format e punës së detyruar por qeveria nuk e zbatoi gjithmonë me efektshmëri këtë ligj. Mungesa e koordinimit mes ministrave dhe natyra sporadike e zbatimit të procedurava standarde të veprimit vështirësuan zbatimin. Dënimet prej tetë deri në 15 vjet në burg ishin mjaftueshëm të ashpra për të frenuar shkeljet. Organizatat e zbatimit të ligjit trajnuan punonjësit e tyre me një qasje me në qendër viktimat e trafikimit njerëzor. Qeveria vazhdoi të identifikonte viktimat trafikimi por ndoqi penalisht dhe dënoi një numër të vogël trafikuesish. Zyra e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit rriti përpjekjet e qeverisë për të parandaluar trafikimin nëpërmjet aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit.

Pati raste të punës së detyruar gjatë vitit. Fëmijët iu nënshtruan lypjes me detyrim dhe aktiviteteve kriminale (shikoni seksionin 7.c.).

Shikoni gjithashtu Raportin mbi Trafikimin e Personave të Departamentit të Shtetit në faqen www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së të miturve dhe moshë minimale për punësim

Amendimet e reja të Kodit të Punës që hynë në zbatim në qershor, përcaktojnë moshën minimale të punësimit në 16 vjeç, por lejonin fëmijët në moshën 15 vjeç të punësohen në kushte të veçanta kur puna kategorizohet si e “lehtë” dhe nuk pengon shkollën. Në përgjithësi, të gjithë fëmijët nën moshën 18 vjeç mund të punojnë në punë të kategorizuara si “të lehta”. Sipas ligjit, Inspektorati Shtetëror i Punës, nën Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqënies Sociale, është përgjegjës për fuqizimin e kërkesave të moshës minimale nëpërmjet gjykatave, por Inspektorati Shtetëror i Punës nuk e zbatoi si duhet ligjin. Inspektorët e punës hetuan sektorin e punës formale, ndërkohë që pjesa më e madhe e punës së të miturve kryhej në sektorin informal. Inspektorati Shtetëror i Punës nuk kryen kontrolle për punën e minorenëve përveçse kur ka ankesa të caktuara.

Pjesa më e madhe e inspektimeve të punës u krye në fabrikat e këpucëve dhe të tekstileve, në call centers dhe në sipërmarrjet me pakicë; zyrtarët gjetën disa raste që përfshinin punë të miturish gjatë inspektimeve të tyre. Dënimet për shkeljet e ligjit rallw u pwrctuan dhe këto nuk ishin të mjaftueshme për të frenuar shkeljet.

Në vitin 2013 agjencia shtetërore e statistikave dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës llogariti 54 000 fëmijë të përfshirë në punë të detyruar në vend. Rreth 43 000 fëmijë punonin në ferma dhe peshkim, 4 400 në sektorin e shërbimeve dhe 2 200 në hotele dhe restorante. Afërsisht 7 përqind e fëmijëve ishin punonjës të mitur.

Ligji kriminalizon shfrytëzimin e fëmijëve për punë dhe shërbime të detyrurara, por qeveria nuk e zbatoi si duhet ligjin. Inspektorati Shtetëror i Punës vëzhgoi raste të punës së minorenëve si dhe shkelje të tjera të ligjit të punës, por burimet e pamjaftueshme njerëzore e kufizuan veprimtarinë e tij. Raportet vërejtën se një pjesë e madhe e punonjësve të mitur punuan si shitës në rrugë ose në dyqane, lypës, fermerë, barinj, kontrabandistë droge, larës makinash, punonjës në fabrika tekstilësh, minierë, ose ilustrues këpucësh. Disa prej fëmijëve që lypin në rrugë ishin brez i dytë ose i tretë lypësish. Kërkimet treguan se lypja niste që në moshën katër ose pesë vjeçare. Ndonëse kodi penal ndalon shfrytëzimin e fëmijëve për lypje, policia në përgjithësi nuk e zbatoi ligjin, megjithëse bëri përpjekje më të mëdha për ta bërë këtë gjatë vitit (shikoni seksionin 6, Fëmijët e zhvendosur).

Sipas Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve, midis qershorit 2015 dhe qershorit 2016, autoritetet referuan në prokurori 24 prindër për abuzim dhe

shfrytëzim fëmijësh, përfshirë edhe punë të detyrueshme. Një hetim për vdekjen e një djali 17 vjeçar në gusht në leadfillin e Sharrës zbuloi se ai kishte punuar në turnet e natës pa një kontratë zyrtare punësimi. Hetimi zbuloi gjithashtu se shumë fëmijë të tjerë punonin në të njëjtat kushte dhe çoi në disa arrestime.

Shikoni gjithashtu Të Dhënat mbi Format më të Këqija të Punës së të Miturve të Departamentit të Shtetit në faqen www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose zanatin

Ligjet e punës e ndalojnë diskriminimin në punë për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar fizike dhe mendore, besimeve politike, kombësisë, besimit fetar, familjes, të jetuarit me virusin e SIDA-s dhe origjinës sociale. Diskriminimi në punësim dhe zanat ndodhi në lidhje me gjininë, paraqitjen e një aftësie të kufizuar, orientimit seksual dhe identitetit gjinor, kombësisë dhe etnisë.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale kombëtare ishte 22 000 lekë (176 dollarë) në muaj. Krahasimisht pragu i varfërisë në nivel kombëtar në vitin 2013 ishte 6 874 lekë në muaj (55 dollarë). Ligji kërkon pagesë të barabartë për punë të barabartë. Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e pagës minimale. Inspektorati raportoi se kishte 113 inspektorë, deri në 110 në 2015.

Ndonëse ligji përcakton javën 40-orëshe të punës, java aktuale e punës u përcaktua me marrëveshje individuale ose kolektive. Ligji përcakton pushime vjetore të paguara, por vetëm punonjësit në tregun formal të punës kishin të drejta për pushime të paguara. Shumë persona në sektorin privat punuan gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesa për orarin shtesë dhe punë gjatë ditëve të pushimit, por punëdhënësit nuk i zbatuan gjithmonë këto përcaktime. Ligji përcakton pagesë shpërblyese për punën jashtë orarit. Qeveria nuk kishte standard për numrin minimal të pushimeve në javë dhe rrallë zbatoi ligje që lidheshin me maksimumin e orëve të punës, kufij në punë jashtë orarit, ose pagesë shpërblyese për punë jashtë orarit, veçanërisht në sektorin privat. Këto ligje nuk zbatoheshin për punonjësit në sektorin informal, si për shembull punonjësit shtëpiakë dhe punonjësit migrantë.

Inspektorati Shtetëror i Punës është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë profesionale. Mungonte në përgjithësi zbatimi. Kushtet e vendit të punës në prodhim, ndërtim dhe sektorin e minierave

shpesh ishin të dobëta dhe në disa raste të rrezikshme. Burimet dhe inspektimet nuk ishin të mjaftueshme dhe dënimet me gjobë deri në 50-fishin e pagës minimale prej 1.1 milionë lekë (8,700 dollarë) shpesh nuk frenuan shkeljet pasi agjencitë e zbatimit të ligjit nuk kishin mjetet për zbatimin e mbledhjes dhe si rrjedhojë rrallë gjobitën shkelësit. Nuk kishte programe qeveritare që të siguronin mbrojtje sociale për punonjësit në ekonominë informale.

Shkeljet e standardeve të sigurisë profesionale ndodhën më shpesh në industritë tekstile, të këpucëve/sandaleve, ndërtimit dhe minierave. Punëtorët shpesh nuk mund të dilnin nga situata që rrezikonin shëndetin ose sigurinë e tyre pa rrezikuar punësimin e tyre. Punëdhënësit nuk i mbrojtën efektivisht punonjësit në këto situata.